REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faqe/Br.str. 367
Data/Datum 19. 11. 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e tetë e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 02.09.2026, në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Festim Pllana, Daut Krasniqi, Kushtrim Mirena, Kosovar Ademi, Besarta Qadraku, Filloreta Musaj, Arlinda Mekolli, Rrahim Sogojeva, Hajredin Mjeku, Afrim Dumani, Laureat Gojnovci, Mirlinda Krasniqi, Jetmir Berisha, Burim Berisha, Saranda Sllamniku, Vjosa Kida Hyseni, Etnik Berjani, Rrahim Tërnava, Valon Murseli, Ermal Dumani, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Aida Alimi, Suhat Ademi, Dashnim Bajrami, Driton Ademi, Gjelbrim Halili, Ali Ismaili dhe Radoman Doderovic.

Mungojnë: Ali Topalli.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Valon Prebreza - Kryetari i Komunës, Bardhyl Koiçiçi - Drejtor për Buxhet dhe Financa, Sabri Xhigoli - Drejtor i Arsimit, Ylber Kelmendi - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, Durim Hajra - Drejtor i Inspeksionit, Arianit Tërmkolli - Drejtor i Infrastrukturës, Mirsad Qyqalla - Drejtor i Bujqësisë, Vildane Latifi - Drejtoresh e Administratës.

Të tjerë: Përfaqësues të Shoqërisë Civile.

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës e datës 30.07.2026.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare në Drejtorinë e Arsimit për vitin 2026.
4. Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare në investime kapitale për vitin 2026.
5. Propozim për modifikimin e projektit zbatues për renovimin dhe zgjerimin e Stadiumit "Ekrem Grajqevci" në Fushë Kosovë.
6. Propozim për shqyrtimin e parë të projekt – Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për vitet 2026-2030.
7. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për lëshimin e lejeve për instalimin e paneleve foto-voltaike në territorin e Komunës së Fushë Kosovës.
9. Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në projekte kapitale për vitin 2026.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje për të gjithë, të nderuar kolegë të Kuvendit Komunal, i nderuar Kryetar, të nderuar drejtor dhe ju të pranishëm ju falenderoj për pjesëmarrjen në seancën e rregullt të kuvendit komunal, e kemi një njoftim nga ATRC-ja, z.Arianita Shala, e cila do të prezentoj para nesh formën dhe mentodën e monitorimit të punës dhe anëtarëve të kuvendit të komunës së Fushë Kosovës, ne kemi pranuar që monitorimi të bëhet nga ta por për detaje të tjera, fjala për z.Arianita.

Arianita Shala: I nderuar Kryetar, Kryesues, Asamblesitë dhe ju të pranishëm, po filloj këtë sesion duke falenderuar Kryesuesin dhe ekipin e tij që ka shprehur gadishmëri për bashkëpunim me këtë projekt, shpresojmë për bashkëpunim deri në fund të procesit. Unë jam Arianita, dhe e përfaqësoj Konsorciumin e përbërë prej Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale, Insititutit GAP, ATRC-së dhe CPM-së, jemi në një projekt që e bëjmë monitorimin e performacës së anëtarëve të Kuvendit në tërë Kosovën, ky projekt financohet nga Qeveria e Suedis, Zvicrës dhe Bashkimit Europian dhe zbatohet në kuadër të projektit DEMOS. Besoj që të gjithë e keni pranuar nga një e-mail informues se si do të shkojë procesi, unë do i tregoj disa detaje dhe nëse keni ndonjë pyetje më pyesni lirisht. Qëllimi i këtij projekti është të vlerësoj performacën e anëtarëve të Kuvendit Komunal, vlerësimi bëhet në tri kategori: roli përfaqësues, roli mbikqyrës dhe roli legjislativ. Roli përfaqësues vlerësohet me 40 pikë, ka më shumë pikë se rolet e tjera sepse kemi konsideruar më të rëndësishme rolin e asambleistit në zhvillimin e takimeve, angazhimin me qytetarët, këshillave lokal, përfshirjen e personave më aftësi të kufizuara, të rinjëve etj, gjithashtu e kemi rolin legjislativ ku vlerësohet kontributi i anëtarëve të Kuvendit gjatë shqyrtimit të akteve Komunale, gjithashtu në rolin mbikëqyrës që është ushtrimi i funksionit mbikqyres ndaj përgjegjësive përmes kërkesave për llogaridhënie ndaj ekzekutivit dhe të tjera. Nga ky monitorim përjashtohen Kryesuesi dhe shefat e grupeve parlamentare, për shkak të korrektësisë që Kryesuesi ka mundësi për të folur më shumë, dhe shefat e grupeve parlamentare ndërsa një asambleistë e ka kohën më të kufizuar gjatë fjalimit. Evidentimi i vlerësimit do të bëhet përmes dokumenteve, fotove, duke i përcjellur rrjetet e juaja sociale, konfirmimi nga procesverbalet etj, ky proces ka filluar nga korriku deri në Mars të vitit 2027, seancat do të monitorohen në këtë periudhë, do të ndahen tri çmime: çmimi për asambleistin më aktiv në tërë Kosovën, çmimi për asambleisten grua më aktive në tërë Kosovën dhe çmimi për asambleistin më të ri në mandat në tërë Kosovën. Ju falenderoj shumë dhe ju uroj punë të mbarë, nëse keni pyetje ose paqartësi urdhëroni.

Laureat Gojnovci: Përshëndetje përfaqësues të Institutit, ju përgëzoj për këtë projekt por si shenjë pakënaqësie e jona është se ne para se me qenë shefa të grupeve parlamentare jemi anëtarë të Kuvendit sepse ne nuk e japim vetëm qëndrimin e subjekteve tona politike por ngrisim çështje dhe si anëtarë të Kuvendit për shkak të përgjegjësisë që kemi ndaj qytetarëve dhe mendoj që është e padrejtë që të mos vlerësohen shefat e grupeve parlamentare. Ju e keni zgjedhur këtë metodë dhe nuk e di sa mundeni ta ndryshoni por thirrja jonë është që të ndryshohet. Ju do të na monitoroni vazhdimisht dhe kur jepim qendrime në emër të grupit mos na vlerësoni por të vlerësohemi kur flasim si anëtarë të Kuvendit për çështjet që i ngrisim, për takimet që i mbajmë me qytetarë, faleminderit shumë.

Migjen Kolshi: Përshendetje për të gjithë pajtohem me Laureatin, që nuk duhet të ketë diskriminim ndaj shefave të grupeve parlamentare sepse dhe ne jemi asambleistë. Është mirë të vlerësohemi në bazë të përformancës si asambleistët sepse është nënçmim për ne, ju faleminderit.
Rrahim Tërnava: Faleminderoj shtetet europiane për ndihmën, hapësira e shefave të grupeve parlamentare është shumë më e madhe sesa e asamblistëve, dhe mënyra si këta e vlerësojnë punën tonë ne nuk mundemi të ndëryjmë por vetëm të japim rekomandime ose sygjerime, une pajtohem plotësisht me propozimin e zonjës që të vlerësohen asambleistët e jo shefat e grupeve parlamentare. Unë do të propozoja që të bëni një projekt ku të vlerësohen vetëm shefat në tërë Kosovën.
Migjen Kolshi: Është e padrejtë aktiviteti jonë të mos vlerësohet, ne jemi asambleistë para se të jemi shefa.
Arianita Shala: Faleminderit për propozimet, ideja për shefat e grupeve parlamentare është e njejtë si me Kryesuesin, ju e dini hapësirën që e ka kryesuesi dhe shefat e grupeve parlamentare gjatë seancës, nuk është e drejtë që një anëtarë i cili nuk është shef i grupit të vlerësohet me metodën dhe pikët e njejta, faleminderit shumë.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë Arianita, ju uroj punë të mbarë. Po fillojmë zyrtarisht seancën e nëntë të rregullt të Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës, pika e parë e rendit të ditës është: Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës e datës 30.07.2026, pika e dytë: Pyetje dhe përgjigje parlamentare, pika e tretë: Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare në Drejtorinë e Arsimit për vitin 2026, pika e katërt: Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare në investime kapitale për vitin 2026, pika e pestë: Propozim për modifikimin e projektit zbatues për renovimin dhe zgjerimin e Stadiumit "Ekrem Grajqevci" në Fushë Kosovë, pika e gjashtë: Propozim për shqyrtimin e parë të projekt – Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për vitet 2026-2030, pika e shtatë: Shqyrtimi i dytë i Projekt – Rregullores për lëshimin e lejeve për instalimin e paneleve foto-voltaike në territorin e Komunës së Fushë Kosovës, dhe pika e tetë: Të ndryshme. Sot me urgjencë na ka ardhur një rekomandim: kërkesë për pikë shtesë të rendit të ditës që është: Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në projekte kapitale për vitin 2026, është propozim i rendësishëm bartja e mjeteve prej 450,000.00€, për shpenzim në realizimin e projektit për asfaltimin i rrugës "Ejup Gashi" me infrastrukturë përcjellëse, me numer të kodit të projektit 20945, ky projekt ka gjatësi rreth 1300m, ku përfshihet rregullimi i trupit të rrugës dhe trotuaret e rrugës me standarte të parapara për ndërtimin e rrugës brenda mundësive buxhetore të lejuara me vendimin e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës, kërkojë mirëkuptimin tuaj për shkak të nevojës urgjente që të investohet në atë rrugë, po e hapi diskutimin për këtë pikë.
Kosovar Ademi: E përkrahim pikën shtesë.
Laureat Gojnovci: Rendi i ditës na ka ardhur me kohë dhe nuk kemi vërejtje ndërsa për pikën shtesë është nevojë e madhe që ajo rrugë të asfaltohet, në parim e përkrahim edhe këtë pikë por kemi vërejtje sepse kjo nevojë është paraqitur më herët dhe ka mundur të vijë si pikë e rregullt e rendit të ditës, po ju lutem që të mos sjellni pika jashtë rendit të ditës, faleminderit.
Aida Alimi: Pershëndetje Kryetar, Kryesues, kolegë asambleistë dhe ju të pranishëm, Kryesues kërkojë që të jesh më i përgjegjshëm që seanca të fillojë me kohë, nëse seanca e radhës nuk fillon

me kohë ne do të lëshojmë mbledhjen e kuvendit, po ashtu pikën shtesë kësaj radhe e mbështesim për të mirën e qytetarëve dhe komunës së Fushë Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë kolegë, çdo vonese mundet të ju ndihmojë juve që të jeni më të përgaditur, është çështje e juaja nëse vendosni të rrini ose jo, faleminderit. Meqenëse nuk ka diskutim tjetër po e qesim në votim kush është "Për", këtë propozim që të futet në rend të ditës?

U votua me unanimitet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Propozimi për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në projekte kapitale për vitin 2026, hynë si pikë e rregullt në rendin e ditës.

Valon Murseli: Përshëndetje për të gjithë, unë kam një kërkesë që është nevojë e qytetarëve, ia kam dorëzuar Kryetarit të Komunës dhe ju është dorëzuar Drejtorit të arsimit, është një kërkesë kryesore me dy nënkerkesa. Për shkak të problemeve që qytetarët po përballen sot me çmimet e kopshteve private, kërkesa e parë është që familjet që kanë më shumë se 1 fëmijë në kopshte private të ndihmohen, kemi mbledhur shifra të numrit të fëmijëve që janë në këto kopshte, është numër i lartë dhe kërkojmë që nga 1 shtatori, se pari të futet si pikë e rendit të ditës dhe të merret vendim që çdo familje që ka më shumë se 1 fëmijë në kopshtë private të mbështetet me shumën prej 100€. Nga të dhënat që kam siguruar janë më shumë se 300 familje që kanë më shumë se një fëmijë në kopshte private, kostoja mujore duhet të jetë rreth 30,000€ dhe vjetore 360,000€, që mendojë se është e nevojshme derisa të krijojmë kapacitete me kopshte publike. Kërkesa e dytë është që nga viti 2028, të subvencionohet me 50% secili fëmijë në kopshte private derisa të rrisim kapacitetet me kopshte publike. Kërkesa e tretë është mundësia e marrjes së objekteve private në adaptim në kopshte publike derisa të krijojmë kushte për kopshte publike. Qyteti i Fushë Kosovës, ka rreth 8076 fëmijë nga mosha 0 deri 6 vjet, e dimë që Fushë Kosova, ka probleme të mëdha me arsimin dhe duhet ti trajtojmë urgjent, prandaj kërkojë të futet si pikë e rendit të ditës që nga 1 shtatori çdo familje e cila ka më shumë se dy fëmijë në kopshte private të ndihmohet, kërkesa e dytë që nga viti 2028, të përkrahet me 50% çdo fëmijë dhe kërkesa që të shqyrtohet mundësia e marrjes së objekteve private në adaptim në kopshte publike pasi që ka mungesë të pronave, faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë nuk kam pranuar asnjë material në lidhje më këtë propozim, nuk ju jeni përmbajtur procedurave të rregullta unë personalisht nuk mundem ta mbështesë sepse kjo formë është e papranueshme, tani fjala është për Laureatin.

Laureat Gojnovci: Çdo gjë që është për të mirën e qytetarëve ne e mbështesim, por është dashur si grup parlamentar të njoftohemi nga propozuesi që po hyn si pikë e rendit të ditës dhe me marrë pëlqimin e grupit tonë parlamentar. Kësaj radhe do të votojmë "Për", por për raste tjera duhet të kemi një dakordim që të mos dështoj si rezultat i votave jo të mjaftueshme.

Kosovar Ademi: Gjatë paraqitjes së propozimit kolegu Valon, na përmendi disa llogaritje të shumave, unë e dëgjova që kosto mujore ishte 30.000€, por me atë shumë mund të ndërtohet një çerdhe e re kshtu që ne si grup parlamentar nuk e përkrahim këtë propozim.

Ali Ismaili: Kryesues të lutem vepro mbi bazën e Rregullores së punës së Kuvendit, asambleisti ka të drejtë të propozojë pikë shtesë dhe ti e qet në votim pastaj a kalon apo jo është çështje tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E qesim në votim propozimin e Valon Murselit.
U votua me: dymbëdhjetë vota "Për", katërmbëdhjetë "Kundër" dhe asnjë abstenim, gjithësej njëzet e katër pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës nuk e aprovoi propozimin.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E qesim në votim rendin e ditës së bashku me propozimin që ka ardhur sot nga ekzekutivi.
U votua me njëzet e tre vota "për" asnjë votë "kundër" dhe një abstenim, gjithsej njëzet e katër pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje gjithësej tridhjetë anëtarë. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u miratua rendi i ditës së bashku me propozimin e ardhur nga ekzekutivi.

Pika e parë (1) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës e datës 30.07.2026
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E hapim diskutimin për këtë pikë.
Kosovar Ademi: E përkrahim.
Laureat Gojnovci: Nuk e përkrahim këtë procesverbal.
Migjen Kolshi: Nuk e përkrahim.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqense nuk ka diskutime tjera, e qesim ne votim.
U votua me gjashtëmbëdhjetë vota "Për" asnjë votë "Kundër" dhe një abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje gjithsej tridhjetë anëtarë.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u votua 'Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datë 30.07.2026'.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani fjala është për ju asambleistë.
Laureat Gojnovci: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam disa çështje që dua të ngrisë, e para ka të bëj me shkollën në Lismir. Mësimi ka filluar në të gjithë vendin ndërsa në Lismir jo, ka pasur informacione se kjo shkollë po tentohet të mbyllet për shkak të disa kushteve të papërshtatshme që i ka gjetur Inspektoriati i Sanitarisë i Ministrisë së Arsimit. Sa kemi qenë në pushtet është ndarë një parcel për ndërtimin e shkollës dhe është futur në buxhet për vitin 2026, mirëpo ai vendim është shfuqizuar, ajo shkollë përveç që është shumë e nevojshme ka dhe një histori të gjatë në Komunën e Fushë Kosovës, bëj thirrje Kryetar që të mbash takime me banorë sepse ka mjete nga renovimi i shkollave dhe bëje një renovim që të filloj mësimi. Çeshtja e dytë që dua të ngrisë është për çertifikata shëndetësore, Drejtoresha e shëndetësisë i ka anuluar në QKMF, dhe e kemi marrë një përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi përkundër kësaj ai vendim nuk është shfuqizuar, qytetarët të cilët kanë nevojë për çertifikata shëndetësore ende nuk po munden ti marin në QKMF dhe dua të di pse nuk po shfuqizohet ai vendim kur Ministria e ka kthyer që është në kundërshtim me ligjin? Çështja e trete

ka të bëj prapë më QKMF-në, pse kryetar nuk po hapet konkursi për drejtorin e QKMF-së, kur tash 6 muaj jemi me ushtrues detyre? Çeshtja tjetër ka të bëjë me publikimin e disa përfituesve për start-up biznese, te ai publikim mungojnë pikët e vlerësimit, raporti i komisionit vlerësues, Kryetar a ka biznese aktive që kanë qenë përfitues të kësaj thirrje sepse thirrja ka qenë për start-up biznese, po ashtu kemi evidentuar që ka njerëz që kanë lidhje me pushtetin që janë përfitues të këtyre subvencioneve, familjar të anëtarëve të Vetëvendosjes në Fushë Kosovë? E fundit ka të bëjë me seancën e jashtëzakonshme sepse kemi marrë kritika nga pushteti për mospjesëmarrje në atë seancë, është e drejtë legjitime e një subjekti politikë për pjesëmarrje ose jo pjesëmarrje në një seancë të caktuar dhe kemi konstatuar që ka shkelje të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, sepse duhet të ketë një ftesë së paku 3 ditë pune para seancës së jashtëzakonshme, dhe nëse e vlerësoni që ftesat përmes vajberit ose sms në telefonë janë ftesë zyrtare, ne vlerësojmë që është gabim. Ftesë zyrtare është kur vjen ne e-mail zyrtar ose privat, ftesa e protokolluar se bashku me material dhe datën e mbajtjes se seancës, kjo ka qenë aryseja e mos pjeseëmarrjes, faleminderit shumë për vëmendje.

Migjen Kolshi: Përshëndetje për të gjithë, para se të filloj me pyetje kam një kërkesë drejtuar Kryetarit të Komunës, juve kryesues dhe gjithë stafit qeverisës të Komunës së Fushë Kosovës, ne si grup parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, kërkojmë që në monitorin e Komunës të shfaqet fotografia "Kosova po pret", është një fushatë në tërë Kosovën, sepse besoj që ata komandanta që gjenden në Hagë, meritojë respektin tonë. Pyetja e parë është për drejtorin e Arsimit, në sa shkolla është intervenuar për përmirësimin e infrastrukturës shkollore, pse nuk është intervenuar në shkollën e fshatit Harilaq? Konkursi i hapur për mësimdhënës, sot përfundon afati i aplikimit sa nxënës janë pa mësues tash në shkollë, përgjegjesi e kujt është kjo? Pyetje për Kryetarin dhe drejtorin e shërbimeve publike në lidhje me mbeturinat, kompania e cila ka fituar tenderin keni thënë që do të punoj me 4 kamionë, kjo nuk ka qenë e vërtetë asnjëherë, ka dalë në monitorin e Komunës që dy herë në ditë do të vijnë ti marrin mbeturinat nëse e shohim tash qyteti është komplet me mbeturina, a keni deshtuar me këtë kontratë dhe a duhet ti kërkoni falje qytetarëve? Në rrugën "Amir Elmazi" është duke u ndërtuar një objekt banesor dhe ajo kompani ndërtuese ka bërë një rrethojë me të cilën e ka uzurpuar pronën publike, e kam kontaktuar drejtorin dhe më ka thënë që ka bërë kërkesë dhe ka marrë leje në Komunë derisa del mbi spërfaqen e tokës dhe të largohet ajo pjesë, objekti ka dal mbi sipërfaqen e tokës dhe rrethoja është ende aty duke krijuar vështirësi të mëdha në komunikacion. Pyetje për drejtorin e shërbimeve publike lidhur me kompanitë transportuese, kam thënë edhe më herët që nëse nuk i subvencionojmë ato kompani do të dështojnë, më të dëmtuarit janë banorët e fshatrave Harilaç dhe Henc, Kryetar a do të ndërmarrësh hapa për të ndaluar këtë problem? Faleminderit shumë.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndetje Kryetar, Kryesues dhe ju kolegë, kam disa pyetje për Kryetarin kam parë në media se i ke larguar nga puna disa punëtor me Caritas, a ka qenë arsyeja për ti punësuar militantët e Vetëvendosjes? Pyetje për drejtorin e arsimit a i keni siguruar të gjitha shkollat me policë civil? Pyetje për drejtorin e urbanizmit do doja të dija deri ku ka shkuar procedura për xhaminë në Fushë Kosovë, sepse disa qytetarë kanë qenë në Komunë për disa mosmarrëveshje në lidhje me xhaminë, a është rregulluar dokumentacioni sepse e dimë që prona

është e AKP-së? Për drejtorin e shërbimeve publike rruga "Gjergj Fishta" dhe "Tahir Zemaj" nuk ka ndriçim, a do të rregullohet, faleminderit shumë.

Valon Murseli: Përshendetje për të gjithë të pranishmit, me datë 30.08.2026, si grup i asambleistëve kemi dërguar 3 kërkesa për auditim ku ka dyshime të bazuara për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe parasë publike, ende nuk kemi pranuar përgjigje për procesin edhe pse kanë kaluar 30 ditë. Me datë 18.08.2026, ju kam drejtuar përseri Njësisë se Auditimit rreth këtij procesi dhe të nesërmen më kanë dërguar e-mail ku kanë thënë se kanë njoftuar Kryetarin dhe po presin një vendim nga ai për të vazhduar tutje me auditim, kerkojë nga kryetari përgjigje publike se do të jap vendim pozitiv që këto procese të auditohen nëse nuk ka dicka për të fshehur, mendoj që është e nevojshme themelimi i komisionit të auditimit pasi që është gjetur si shkelje edhe më herët. Pyetje për Kryetarin dhe drejtorin e arsimit, te objekti Eliza C, Komuna e Fushë Kosovës ka në pronësi 1000m2 tokë përmes procesit të bonuseve dhe 400m2 lokal, pse në këtë parcelë nuk planifikohet të ndërtohet një shkollë fillore që është shumë e nevojshme apo kjo parcel planifikohet të ju ipet personave të tretë me anë të ndojë kontrate të partneritetit publiko-privat, për aktivitete tjera që në këtë rast e kundërshtojme fuqishëm. Pas pranimit teknik të këtij objekti, a keni në plan që në ato lokale të krijohen kushte për një kopsht publik? Kopshti i cili po ndërtohet të aneksi 2, në cilen fazë është? Pyetje për Kryetarin dhe drejtoreshën e zhvillimit ekonomik, para dy dite ka dalur lista e përfituesve të bizneseve start-up, shuma e shpenzuar është rreth 120,000.00€, në këtë listë ka shumë familjar të ngushtë të pushtetit aktual, po ashtu ka dyshime se bizneset kane qenë të regjstruara zyrtarisht. Kërkesë për sqarim nga drejtori i bujqësisë në thirrjen publike për subvencionim të fermerëve të prodhimit të qumështit, një nga pikat që është diskriminuese është që çdo fermerë që ka mbi 20,000 litra qumësht të prodhuara në gjashtë muajt e fundit nuk do të subvencionohet, pra një fermerë që ka mbi 40,000 litra qumësht demtohet dhe nuk merr subvencionim, a do të merren mjetet për gjashtë mujorin që ka kaluar? Pyetje për drejtorin e kulturës, këto ditë së bashku më Asamblin Zëri keni qenë në Turqi, udhëtimi juaj a ka kaluar përmes kategorisë VIP, sa ju ka kushtuar bileta pasi që Asambli ka udhëtuar me autobus? Pyetje për kryetarin për transportin publik qytetarët qe 20 ditë nuk po e marrin këtë shërbim, pse nuk është arritur me kohë një marrëveshje me kompanitë e autobusëve, këto kompani a e kanë zbatuar marrëveshjen që ka qenë më herët, sepse kam informata që edhe pse është rritur çmimi i naftës këto kompanitë nuk e kanë rritur çmimin e biletës më shumë se 0,50cent. Kërkesa tjetër është lirimi i hapësirave publike te Britania Home, që tashmë janë liruar, kam marrë përgjigje pozitive nga Inspektoriati të cilët i falenderoj dhe drejtorin e infrastrukturës, por çka mbetet shqetësues në këto parqe 1,2 dhe 3 në rrugën "Amir Elmazi", vlera totale e kontratës është 249,000.00€, ndërsa vetëm projekti në rrugën "Amir Elmazi" është 123.000.00€, shportat janë kontraktuar në vlerë 200€, dyfishi i çmimit të tregut, ulëse në vlerë 400€ copa, shtyllat elektrike në vlerë 350€ plus puna 50€ dhe disa ulëse kryesore në vlerë 2000€. Një kërkesë është nga një qytetarë për ndriçim dhe asfaltimi në rrugën "9 Prilli" në Vragoli.

Etnik Berjani: Përshëndetje të nderuar të pranishëm, shumicën e pyetje veç i thanë kolegët, mosmbështetja e kompanive të transportit nuk i dëmton vetëm kompanitë por i dëmton edhe qytetarët, nxënësit, puntorët që autobusin e kanë mjetin kryesor për lëvizje, kam parë në rrjete

sociale një qasje jo të drejtë të kryetarit ndaj këtyre kompanive, komuna e Prishtinës i subvencionon operatorët e vet dhe në raport me operatorët tonë ne dëmtohemi, a do ti subvenciononi këta operator apo do ti injoroni? Pyetja tjetër siç dihet gjendja me mbeturina është kritike, ne kemi një kontratë me kompaninë "Pastrimi", nuk e di pse kryetari e ka injoruar takimin me kompaninë "Pastrimi" dhe kryetarët e komunave.

Ali Ismaili: Nuk dua të zgjatem shumë, në të kaluarën jemi kritikuar shumë për mos rregullimin e mikrofonëve dhe një biletë që ka shkuar drejtoresha e administratës në Turqi, mund ti rregullonte këta mikrofonë, është mirë të na tregoni dhe ftesën që e kanë pasur për atë udhëtim, sepse nëse ka qenë ftesa nga OJQ që ne e kemi subvencionuar atëherë mund të jetë konflikt interesi, faleminderit.

Rrahim Tërnava: I nderuar kryesues kam një propozim që dua të futet si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme, që produktet me origjinë nga Serbia, mos të blehen nga komuna, hapësirat publike komunale mos të shfrytëzohen për reklamime të produkteve serbe, çfardo furnizimi me mallëra serbe mos të paguhet nga komuna e Fushë Kosovës, të respektohen prodhimet vendore, faleminderit.

Jetmir Berisha: Përshendetje të nderuar kolegë, drejtor dhe ju të pranishëm, fusha e sportit në Grabovc, ka nevojë për ndërrimin e barit sintetik, për shkak të fëmijëve të fshatit. Pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë dhe kryetarin, aktivizimi i AMF te rruga "28 Nëntori", gjatë vikendeve nuk po punon, urgjenca është shumë e ngarkuar, besoj që me rritjen e stafit do të rriten shërbimet ndaj qytetarëve. Rruga Bardh i Madh – Grabovc – Sllatinë, është e shkatërruar, e dimë se Ministria ka ndarë disa mjete për këtë rrugë por ende nuk kemi përgjigje deri ku ka mbërritur ky projekt, kërkojë që të paktën të mbyllen ato gropa deri në realizim të atij projekti. Transporti është problem për banorët e atyre fshatrave, besoj që të zgjidhet ky problem sa më shpejtë sepse është urgjente për qytetarët. Kemi nevojë për intervenim në dy lagjet e rrugës "12 Qershori", për kanalizimin që është i dëmtuar, edhe te lagjia "Muzhaku" është i njëjti problem, dhe është mirë të intervenohet sa më shpejtë. Kompania "Pastrimi" me aq sa ka pasur kapacitete ka punuar, ka pasur rekord me sasi të mbeturinave këtë vit, por jemi munduar maksimalisht qe të mos eskaloj situata më kapacitetet që kemi. Ne jemi njësi që i raportojmë komunës dhe jemi në kontakt më drejtorin Izja Mjeku për çdo veprim, shpresoj që të vijnë kamionët e rinje dhe të rritet kapaciteti, sepse nëse do të kishim kapacitete të mjaftueshme nuk do të duhej komuna të kontraktonte dikë tjetër.

Kosovar Ademi: Përshëndetje për të gjithë, kam bërë një reagim në facebook në lidhje me mos pjesëmarrjen e partisë opozitare në seancën e jashtëzakonshme që e kundërshtoi shefi i grupit parlamentar të LDK-së, e dimë se me ligj minimalisht 3 ditë pune para seancës duhet të njoftohen asamblistët, dhe ne kemi njoftuar me anë të vaiberit kolegët gjë që ka ndodhur edhe në të kaluarën, pse po e kundërshtoni metodën e juaj, do të ishte mirë të tregoni arsyet reale të mospjesëmarrjes. U përmend edhe transporti, kryetari ka tentuar që të gjejë një bashkëpunim me kompanitë, ju ka ofruar mundësi, nuk ju kanë pëlqyer kështu që vazhdojmë tutje.

Laureat Gojnovci: E inkurajoj shefin e grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosjes, që të marrë fjalen ndonjëherë edhe për ndonjë iniciativ ose ndonjë problem që ka sepse sa herë flet në foltore, flet si replikë ndaj meje. Niveli i debatit nuk është për kuvend komunal, nuk je i denjë për të na dhënë përgjigje neve.

Ali Ismaili: Ne nuk kemi kohë për të humbur duke dalur asambleistët këtu për të disktuar kur koha është për pyetje, jemi duke pritur rendin e ditës për të vazhduar me pika tjera, pyetjet i kemi bërë për ekzekutivin dhe përgjigjet i presim nga ekzekutivi. Me rregullore nuk ka replika në këtë pikë, kjo nuk është në rregull.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit për kontributin, një pyetje shtesë e ka kërkuar Migjeni, fjala për ju.

Migjen Kolshi: Propozimin që e bëri kolegu Valon Murseli, kolegu nga lista serbe nuk e përkrahu, ndërsa procesverbali kaloi me votën e gjashtëmbëdhjetë të tij, a jeni në kualicion me të?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Drejtohu me shkrim të lutem dhe merr përgjigje, e konstatojë që ka përfunduar koha e pyetjeve, vazhdojmë me përgjigjet nga ekzekutivi.

Drejtori i Bujqësisë: Pyetjen që më bëri asambleisti Valon, lidhur me fermerin që ka mbi 40.000 litra qumësht dua të dijë cili është sepse në listën që kam të aplikuesve nuk ka asnje fermerë me atë sasi të qumështit, pjesën tjetër e quajte diskriminuese nuk e di arsyen, sepse jemi duke i mbështetur fermerët, gjë e cila nuk ka ndodhur më heret, besoj se është e mirë kjo inciativë dhe shpresoj që në të ardhmen të rritet akoma ndihma për fermerë, faleminderit.

Drejtori i Arsimit: Përshëndetje për të gjithë, i dëgjova me vëmendje pyetjet, me komunitetin e Lismirit e kam pasur një takim, nuk ka zgjidhje të shpejtë shkolla duhet të rrënohet dhe të gjendet një lokalitet i përshtatshëm të ndërtohet shkolla dhe fëmijët ta zhvillojnë procesin mësimor. Nesër kemi takim me banorët e Lismirit së bashku me kryetarin dhe mendoj personalisht që duhet të intervenohet në objektin e tanishëm, për përmirësimin e kushteve. Propozim ka qenë edhe që fëmijët të vijojnë mësimin përkohsisht në gjimnazin "Hivzi Sylejmani" dhe të ju mbulohet shpenzimet e transportit, një propozim i tillë është kundërshtuar nga komuniteti, shpresoj që sa më shpejtë të gjejmë zgjidhje të këtij problemi. Sa i përket renovimit të shkollës në Harilaç, është një shpallje publike dhe kjo shkollë është në plan të renovimit dhe do të ketë renovim gjeneral. Unë si e kam marrë pozitën e drejtori jam angazhuar që shpallja e konkurseve të ndodhë sa me shpejtë, i dini problemet që ka Fushë Kosova me norma. Pyetja për sigurinë në shkolla, prezencë fizike të policisë në të gjitha shkollat nuk ka, policia do të jenë në vëzhgim të vazhdueshëm të të gjitha shkollave sa i përket sigurisë. Sa i përket parcelës te Eliza C që u përmend, fletë poseduese nuk kam pas përveç nga ti, tash e tutje do të angazhohem maksimalisht që të ndërtohet një shkollë atje konform mundësive dhe hapësirës që është. Kopshti modular është në përfundim e sipër, në rrugën e Uglarit. Në shkollën e Grabovcit, do të ketë renovime por në paramasa fusha e sportit nuk është e paraparë, vetëm amfiteatri prapa objektit shkollor, por kjo nuk do të thotë që në planifikimet e ardhshme nuk do të jetë kjo fushë. Unë kam pasur dy takime me përfaqësuesit e kopshteve private, ka qenë propozim i kryetarit të komunës që të shikohet mundësia që të subvencionohen asistentët të cilët janë të angazhuar nga familjarët e këtyre fëmijëve në kopshte private, më pastaj ka dalur ideja e subvencionimit ndërkohë unë dhe nënkryetari kemi pasur takim me ministrin e arsimit, kemi diskutuar për nevojat e Fushë Kosovës, për rritjen e rrjetit të kopshteve publike, dhe nëse gjenden objektet private ose publike dhe me qera ministria do të na ofrojë mbështetje, ne jemi në hulumtim të këtyre objekteve diçka konkrete nuk kam ende, faleminderit.

Drejtori i Shërbimeve Publike: Përshëndetje për të gjithë, në fushën sportive në Grabovc, janë rregulluar koshat, rrethoja dhe janë lyer disa pjesë metalike ndërsa bari sintetik jo sepse nuk ka pasur kontratë të mirëmbajtjes, besoj se në të ardhmen do të rregullohet. Sa i përket ndriçimit në Vragoli, në rrugën "Gjergj Fishta" dhe "Tahir Zemaj", ju njoftoj se procedurat janë në prokurim për një projekt për ndriçim në Fushë Kosovë, dhe besoj që ky problem do të zgjidhet. Me kompanitë transportuese kemi biseduar, unë kryesuesi i kuvendit komunal dhe drejtori i financave, kemi rënë dakord që ata të fillojnë punën dhe ne të gjejmë mënyrën për ti përkrahur, nuk e di pse nuk kanë filluar punën, menyra se si janë subvencionuar nga pushteti i kaluar nuk ka qenë në rregull dhe ka qenë jashtëligjore. Sa i përket mbeturinave në Fushë Kosovë, gjendjen e kemi gjetur shumë të rëndë, kjo është pasojë e keqmenagjimit nga kompania regjionale "Pastrimi", si te ne ashtu dhe në komuna tjera, ne kemi kontraktuar një kompani tjetër me një çmim më të lirë, është model i mirë që kanë kërkuar edhe komuna tjera me bër një jë të till, gjendja është më e mirë sesa që ka qenë dhe do të përmirësohet akoma, faleminderit.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Konstatojë se është konsumuar kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e tretë (3) - Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare në Drejtorinë e Arsimit për vitin 2026.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ftoj drejtorin e arsimit, ta paraqesë këtë pikë.
Drejtori i Arsimit: Një numër i madh i shkollave aktualisht janë keq me invertarë, shkolla e re në rrugën "Fazli Grajcevci", nuk është paraparë furnizimi me invertarë, duke marrë parasysh se nuk kemi mundësi tjera kemi ardhur në përfundim në koordinim me drejtorinë e financave që të barten 150,000.00€, nga një kod ku ne për një furnizim të tillë nuk mund të kemi qasje, barten në një kod tjetër që pastaj të mundemi ti destinojmë ato mjete për blerjen e invertarit. Unë pres që ky propozim të përkrahet nga ju dhe të kemi mundësi që të furnizojmë shkollat me invertarë.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E hapim diskutimin, Lëvzija Vetëvendosje qëndrimi juaj?
Kosovar Ademi: Drejtori e sqaroi shumë mirë, dihet se shkollat kanë nevojë të madhe për invertarë kshtu që ne e përkrahim.
Laureat Gojnovci: I kam thënë drejtorit të arsimit që nuk është në domenin e tij që të bëj lëvizjen e kodeve buxhetore, ju e bëni kërkesën te kryetari ose drejtoria përkatëse dhe ata pastaj bëjnë propozimin. Ky material ka anomali, jeni thirrur në nenin 15 të Ligjit për ndarje buxhetore, ky nenë e lejon lëvizjen e mjeteve brenda investimeve kapitale, nëse ky vendim kalon unë do të ankohem sepse po i merrni mjetet nga investimet kapitale po i qitni në mallëra, nuk ke të drejtë drejtor ne nuk e përkrahim këtë pikë. Sa i përket pikës së Lismirit, ne e përkrahim.
Migjen Kolshi: Sa i përket këtij propozimi, Laureati e elaboroj shumë mirë, nuk ka të drejtë drejtori nga investimet kapitale të shkojë te mallërat dhe shërbimet, ne si Parti Demokratike, nuk e përkrahim këtë pikë. Sa i përket pikës së Lismirit, ne e përkrahim.
Ali Ismaili: Kryetar, propozuesit e pikave të rendit të ditës nuk po janë prezentë në seancë të Kuvendit dhe as në Komitetë për Politikë e Financa, është problem të diskutohet pa prezencën e tyre. Kur vie një pikë e rendit të ditës dhe kërkohen 150,000.00€, të merren nga një investim kapital, pse drejtor nuk na ke elaboruar se cilin investim nuk ke mundur ta realizosh deri në këtë

muaj dhe meqenëse nuk po mundesh me e realizuar atë investim capital, po ja merr paratë dhe ato para po i dërgon në arsim, nuk e kam të qartë çka po lëjm keq te investimet kapitale? A lejohet ligjërisht që paratë nga investimet kapitale të barten në mallëra dhe shërbime? Nëse investimet kapitale nuk janë realizuar deri tash, pse nuk janë realizuar? Jemi në pozitë të keqe sepse duhet të votojmë dhe duhet të jemi të informuar saktë cili investim kapital nuk po bëhet, të lutem elaboroni pikat më mirë, gjendja në arsim është shumë e rëndë siç e dimë, sidoqoft do e mbajë premtimin që e kam dhënë për arsim dhe do ta votojë këtë pikë, dhe për arsye se planifikimin e buxhetit për këtë vit nuk e keni bërë ju,te kjo pikë pajtohem.

Driton Ademi: Drejtor i arsimit, nuk duhet ta lejosh juristen e derjtorisë të na qes hi syve, sepse neni 15 dhe pikat e tij nuk kanë lidhje me këtë temë, preambula e formulimit të pikave të rendit të ditës është jashtë rregullave të lojës. Nëse marrim mjete nga investimet kapitale për mallëra dhe shërbime është një lloj degradimi, kuvendi ka të drejtë të miratoj bartjen e mjeteve deri në shumën 5%, ministria 10%, qeveria 15%, parlamenti mbi 20%, unë këtë do ta votojë për shkak të nxënësve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqenëse nuk ka të tjerë po e qesim në votim, Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare në Drejtorinë e Arsimit për vitin 2026, kush është "Për"?

U votua me: tetëmbëdhjetë vota "për", gjashtë "kundër" dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës e aprovoi "Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare në Drejtorinë e Arsimit për vitin 2026" dhe mori:

VENDIM

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1427, të datës 11.08.2026, për ridestinimin, transferimin dhe rishpërndarjen e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej: 150,000.00€, programi Arsimi Fillor Nr, 93030, nga projekti kapital 'Blerja e pajisjeve për shkollat fillore në Komunën e Fushë-Kosovës', kodi i projektit Nr. 20854, nga kategoria Investime Kapitale Nr. 30, në kategorinë Mallëra dhe Shërbime Nr. 13, si vijon:

1.1 Shuma e mjeteve financiare prej: 100,000.00€ nga fondi burimor 10, transferohen për shpenzim prej kodit funksional Nr. 0912, nga kategoria ekonomike Nr. 30, në kodin funksional Nr. 0912, në kategorinë ekonomike Nr. 13 dhe

1.2 Shuma e mjeteve financiare prej: 50,000.00€ nga fondi burimor 21, transferohen për shpenzim prej kodit funksional Nr. 0912, nga kategoria ekonomike Nr. 30, në kodin funksional Nr. 0912, në kategorinë ekonomike Nr. 13.

2. Shumat e mjeteve financiare të evidentuara në paragrafin 1 dhe nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2, për mallëra dhe shërbime shpenzohen në programet buxhetore: Arsimi Fillor Nr. 93030 - Shkolla Fillore 'Mihal Grameno', Fushë-Kosovë, nën-programi Nr. 93031, prej fondit burimor Nr. 10 dhe Arsimi Fillor Nr. 93030 - Shkolla Fillore 'Mihal Grameno', Fushë-Kosovë, nën-programi Nr. 93031, prej fondit burimor Nr. 21.

3. Mjetet financiare të transferuara nga paragrafi një dhe dy, të këtij vendimi do të shfrytëzohen për 'Blerjen e inventarit shkollor për objektin e ri shkollor të ndërtuar në rrugën 'Fazli Grajçevci', me pajisje bazë, në veçanti banka dhe karrige për shkollën e re.

Pika e katërt (4) - Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare në investime kapitale për vitin 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare në investime kapitale për vitin 2026, po e hapi diskutimin.

Kosovar Ademi: E përkrahim këtë propozim.

Laureat Gojnovci: Kjo pikë është nga drejtoresha e zhvillimit ekonomik, e cila nuk ka qenë prezente dje në komitetë dhe as sot ska ardhur me i dhënë sqarimet e nevojshme, ne nuk e përkrahim këtë pikë.

Migjen Kolshi: Sa i përket kësaj pike, e tërë bota po shkojnë nga energjia e ripërtritshme ndersa kjo qeversije i merr projektet nga energjia e ripërtritshme i dërgon në zhavor, ndoshta është strategji nga Vetëvendosja në qendër, ne si Parti Demokratike e Kosovës nuk e përkrahim.

Ali Ismaili: Te kjo pikë kryetar duhet të jepet një arsyeshmëri pse nuk ka mundur të realizohet ky investim, drejtorët duhet të jenë më të përgjegjshëm, të vijnë në seancë dhe ti elaborojnë propozimet e tyre, faleminderit.

Driton Ademi: Nëse ekzekutivi e ka parë që me një projekt nuk po shkon dicka, gjasat reale për tu përmbushur brenda vitit fiskal nuk ekzistojnë, ndërsa nëse një investim tjetër kapital vërehet që ka një dinamikë më të madhe për ta realizuar mund të barten mjetet sepse janë kategori e njejtë dhe duhet ta pranojmë. Te këto formulimet drejtor është mirë të merrni përgjegjësinë ju dhe zyrtari, këtë po e kërkojë, faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit meqenëse nuk ka diskutime tjera po e qesim në votim, Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare në investime kapitale për vitin 2026.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota "për", pesë "kundër" dhe një abstenim, gjithsej njëzet e tre pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës e aprovoi "Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare në investime kapitale për vitin 2026" dhe mori:

VENDIM

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1490, të datës 24.08.2026, për ridestinimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej: 170,000.00€, nga projekti kapital në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, programi buxhetor Zhvillimi Ekonomik Lokal Nr. 48002, për ndërrimin e emërtimit të projektit kapital 'Sistemi solar në institucionet e Administratës, Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Arsimit', kodi i projektit Nr. 56109 dhe bartjen e tyre për shpenzim në projektin e Drejtorinë e Shërbimeve Publike, programi buxhetor Infrastruktura Publike Nr. 18162, për realizimin e projektit kapital me emërtim të ri 'Zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse për qasje të re në Parkun Rekreativ të Pishave' nga fondet burimore - burmet e financimit si vijon:

1.1 Shuma e mjeteve financiare prej: 100,000.00€ nga Granti qeveritar për realizimin e projektit kapital 'Zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse për qasje të re në Parkun Rekreativ të Pishave' dhe

1.2 Shuma e mjeteve financiare prej: 70,000.00€ nga të Hyrat vetanake të komunës për realizimin e projektit kapital 'Zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse për qasje të re në Parkun Rekreativ të Pishave'.

2. Mjetet financiare të ridestinuara për realizimin e projektit kapital me emërtim të ri 'Zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse për qasje të re në Parkun Rekreativ të Pishave', do të shfrytëzohen

për realizimin e projektit kapital të evidentuar në paragrafin një (1), nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 të këtij vendimi.

Pika e pestë (5) - Propozim për modifikimin e projektit zbatues për renovimin dhe zgjerimin e Stadiumit "Ekrem Grajqevci" në Fushë Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim Propozimin për modifikimin e projektit zbatues për renovimin dhe zgjerimin e Stadiumit "Ekrem Grajqevci" në Fushë Kosovë, e ftoj drejtorin të na paraqesë propozimin.

Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit: I nderuar kryetar, kryesues, të nderuar asambleistë dhe ju të pranishëm, ne si drejtori po ju paraqesim këtë propozimin për ndryshimin e projektit të stadiumit "Ekrem Grajqevci", ky ndryshim vjen pasi Federata e Futbollit të Kosovës, ka shkëputur marrëveshjen e bashkëfinancimit duke e bërë të pamundur realizimin e projektit të mëparëshëm. Për ta bërë stadiumin modern me tribuna, parking, ndriçim, kërkojmë votën tuaj për projektin e ri. Arsyeja ju tregova që është tërheqja e Ferderatës nga ky projekt bashkëfinancues ku 1,800,000€, do të investoheshin nga Federata nga 2,800,000 €, sa ka qenë vlera totale e projektit, kur jemi te pasqyra financiare deri më tash janë shpenzuar mbi 400,000.00€, në fazën e parë ndërsa për finalizimin e plotë të stadiumit nevojiten edhe 1,000,000 €, shtesë. Para jush e keni projektin ideor të realizuar nga drejtoria e urbanizmit dhe mund ta shikoni. Ju ftoj ta votoni këtë propozim që të ju hapim rrugë përfundimit të punimeve, dhe qyteti të ketë stadiumin e tij, faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit drejtor, po e hapim diskutimin Lëvizja Vetëvendosje fjala për ju.

Kosovar Ademi: Memorandumi me Federatën ka qenë fiktiv, nuk është në domenin e saj që të bëjë investime të tilla, deri më tani me informacionet që kam 20% e projektit është kryer, meqenëse tërheqja e Federatës e pamundëson që projekti të vazhdojë në mënyrën siç ka qenë i planifikuar, e përkrahim këtë pjesë dhe të vazhdojmë tutje dhe të përfundohet projekti me mjetet e mbetura.

Laureat Gojnovci: Si mundemi ta trajtojmë këtë pikë kur ka kaluar fazat e prokurimit, a do ta shkëputni kontratën, a do të shtoni para për këtë investim, sepse në fletën që kemi nuk specifikohet asgjë, projektin ideor e pamë, po shumica nuk jemi inxhinera që ti lexojmë paramasat, kemi nevojë për sqarime. Gjendja në stadiumin e Fushë Kosovës, duhet të rregullohet dhe jemi pro kësaj vetëm duam të dimë si do të zhvillohen procedurat, a do të nxjerrim rekomandim sot që ti japim të drejtë drejtorisë së sportit ta modifikojë projektin apo marrim vendim për të modifikuar projektin, ne nuk jemi kompetentë me modifiku projektin. Ne i votojmë propozimet mirepo kemi nevojë për sqarim për këtë pikë të rendit të ditës, faleminderit.

Migjen Kolshi: Unë rash në lajthitje pak me fjalët e drejtorit dhe të shefit të grupit parlamentar sepse jam marrë me këtë çështje, kam kerkuar sqarim nga Federata, dhe ata më kanë thënë që e kanë përfunduar punën e tyre dhe i ka mbetur komunës të përfundojë ndërtimin e stadiumit. Besoj që çdo banor i Fushë Kosovës dëshiron të ketë një stadium modern, kam disa pyetje drejtor për këtë projekt sepse nuk jam inxhinier që ta kuptojë çfarë do të ndodhe me ndriçimin, tribunat etj. A do ti ndërprehet kontrata kontraktuesit, sepse nëse i ndërprehet e dimë të gjithë se çka thotë ligji i prokurimit, këtë vit janë të ndara 235,000.00€, për fazën e dytë, a ke kontaktuar drejtor me

kompaninë e cila është duke i zhvilluar punimet në stadium, a do të ketë implikim shtesë nga kuvendi komunal, nga cila kategori do të merren ato mjete nëse ka shpenzime shtesë, kështu do ta kishim më të qartë se a duhet ta votojmë këtë propozim sepse Fushë Kosova ka nevojë për stadium dhe shumë fusha të tjera të rregullohen, faleminderit shumë.

Ali Ismaili: Dje në komitetë i kam parashtruar disa pyetje dhe të njejtat do i parashtroj edhe këtu, drejtor mungojnë të dhënat financiare në propozim, nuk përcaktohet qartë sa do të kushtojë modifikimi, zgjerimi i projektit dhe nëse ka shtesë për buxhetin e komunës? Mungon projekti teknik, e keni sjellë sot projektin ideor mirepo ate teknik jo? Nuk sqarohet nevoja konkrete për ndryshim, në këtë fletë është arsyetimi i përgjithshëm, mungon analiza e ndikimit në buxhet, nuk sqarohet nëse modifikimi do ta rris vlerën e projektit etj, të dhëna të cilat një asambleist duhet ti ketë, kuvendi duhet të vendos mbi bazën e dokumenteve të plota e jo mbi bazën e një flete për një projekt madhor që i ka munguar Fushë Kosovës. Nuk e di nëse ky projekt duhet ta ketë edhe debatin publik, të pyeten qytetarët çfarë stadiumi duan, të gjitha këto drejtor është dashur të jenë në material e jo të bëhet propozimi me një fletë sepse e kemi të paqartë çka po votojmë, faleminderit.

Driton Ademi: Jemi duke folur për një projekt i cili është në fazën e implementimit, mendoj që nuk ka pasur nevojë për projekt ideor, është ndryshim i pozicioneve, një menagjer i kontratës e ka vërejtur në terren se mundet diçka të duket më mirë, ka ardhur deri te prokurimi, prokurimi e ka propozuar te kryetari dhe kryetari e ka sjellë në kuvend ashtu siç është procedura mirepo përderisa nuk cënohen kriteret për kushtet e përgjithshme të kontratës ne mundemi me ec përpara, pra na duhet një vlerësim se mos po i cënojmë kushtet e kësaj kontrate, faleminderit.

Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit: Sa i përket kodit ku do të merren paratë, janë nga investimet kapitale 300,000.00€, ndërsa paratë tjera do ti shtojmë në buxhet për vitin e ardhshëm dhe po ashtu do të jenë nga investimet kapitale. Nuk jemi të interesuar ta ndërprejmë bashkëpunimin me operatorin i cili është duke punuar edhe ai është i interesuar më gjetë një marrëveshje dhe sa më shpejtë të përfundojnë punimet, ne po presim që të votohet ky ndryshim i projektit dhe më pas me grupin punues do ta bëjmë projektin final i cili do të dorzohet në kuvend, gjithç ka do të jetë transparente.

Laureat Gojnovci: Nëse në mbledhjen e ardhshme e sjellni një propozim që ta bëni një ridestinim të mjeteve, për momentin skeni ridestinim të mjeteve brenda kategorisë së njejtë, a po nxjerrim ne rekomandim kundrejtë atij grupi punues për hartimin e stadiumit "Ekrem Grajqevci", a do ta modifikojnë ata projektin apo ne sot, çka po ndyshohet në projekt sepse nuk po e dimë drejtor?

Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit: Ne do ta kemi një investim më të vogel për shkak se projekti i kaluar ka qenë më i madh.

Kryetari i Komunës: Në këtë kuvend është marrë një vendim për shpronësim të pronave të AKP-së, elaborati ka shkuar në Ministri dhe është duke u trajtuar, njëra nga ato prona është 12 hektarë në Nakaradë pikërisht për ndërtimin e stadiumit të ri të qytetit. Stadiumi me të gjitha standartet do të jetë në Nakaradë, ky stadium që po flasim tash nuk i plotëson kushtet sepse vendi është i ngushtë, do të jetë stadium ndihmës do ta shfrytëzoj klubi, qytetarët, nuk kemi alternativë tjetër për shkak të tërheqjes së Federatës.

Migjen Kolshi: Ne e kemi vështirë të votojmë sepse duhet të na sjellni neve një memorandum bashkëpunimi që ne të besojmë që është tërhequr kompania, sepse nëse ju e shkëputni kontratën ai më ligj të prokurimit mundet të marrë 70% të shumës totale, andaj kërkojë që të shtyhet për seancën tjetër që materiali të jetë më i kompletuar dhe ne do ta përkrahim.
Ali Ismaili: Kryetar në propozim mungojnë të dhënat financiare, materiali duhet të jetë më sqarues për ne, të dimë çka po votojmë sepse si asambleistë duhet të jemi të informuar detajisht për këtë projekt.
Kryetari i Komunës: A e votoni sot apo e shtyeni për seancën tjetër, atë pjesë e vendosni ju. Shkolla ne Lismir, edhe këtë vit ka mundësi të zhvillohet mësimi aty për shkak se projekti nuk ka filluar akoma, në buxhet i kemi mjetet e ndara për këtë vitë dhe vitin e ardhshëm, në takimin e nesërm do të vendosim bashkarisht me banorët. Mundësi për tu ndëruar shkolla në prona të komunës në Lismir nuk ka, duhet të gjejmë një zgjidhje: ose të bëjmë këmbim prone më ndonjë banorë të fshatit Lismir ose ta gjejmë tokën ta blejmë. Prona në të cilën më the Laureat, ta ndërtojmë nuk e plotëson kriterin ligjor sepse është afër impiantit. Pyetja për start-up biznese, pati akuza që përfitues janë familjar të VV-së, a mund të di cilët janë, sepse nuk besoj që ka, komisoni është profesional. Migjen, banerin para komunës do ta rregullojmë si komunat e tjera, te rruga "Amir Elmazi", me drejtorin do të bisedoj për bllokimin e hapësirës publike. Te lagjia Eliza C, Valon e përmende që janë 1000m2 tokë dhe 400m2 lokal, kjo është e vërtetë vetëm se shikoje pozicionin e asaj toke dhe mundësinë çka mund të bësh me të, është pjesë e ngushtë që nuk mundemi të ndërtojmë asgjë. Dje është bërë thirrja publike për linjën e re Lismir – Grabovc – Fushë Kosovë, këta banorë do të bëhen me linjë të re të autobusëve, sa i përket fshatrave Harilaç dhe Hencit, kush dëshiron le të punon, vijat që i kanë pasur obligim ligjor nuk i kanë mbajtur si duhet asnjëherë, autobusët i kanë jashtë standardeve, ne si komunë nuk kemi mundësi ti subvencionojmë kompanitë për momentin, vitin e ardhshëm do të bëjmë pagesë mujore për nxënësit dhe studentët, kjo është mundësia jonë. Propozimi që e patë Valon Murseli për çerdhe, kalkuloje saktë sa kushton, iden për të marrë objekte me qera veç se e kemi inicuar, faleminderit.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit kryetar, meqenëse është konsumuar debati për këtë pikë, po e qesim në votim Propozimin për modifikimin e projektit zbatues për renovimin dhe zgjerimin e Stadiumit "Ekrem Grajqevci" në Fushë Kosovë, kush është "Për"?
U votua me: shtatëmbëdhjetë vota "për", asnjë "kundër" dhe gjashtë abstenime, gjithsej njëzet e tre pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës e aprovoi "Propozimin për modifikimin e projektit zbatues për renovimin dhe zgjerimin e Stadiumit "Ekrem Grajqevci" në Fushë Kosovë" dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1484, të datës 21.08.2026, për modifikimin dhe ndryshimin e projektit zbatues nga emërtimi 'Renovimi dhe zgjerimi i Stadiumit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë, në në 'Objekt me destinim sportiv multifunksional - Stadiumi 'Ekrem Grajçevci, i cili është duke u realizuar në Ngastrën Kadastrale Nr. 776-34, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë.

2. Modifikimi i projektit bëhet me qëllim të përshtatjes me gjendjen faktike në terren, përmbushjes së kërkesave teknike të zbatimit, si dhe rritjes së funksionalitetit, cilësisë dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të objektit sportiv.
3. Realizimi i modifikimit do të bëhet në përputhje me dokumentacionin teknik të rishikuar dhe procedurat ligjore në fuqi, duke respektuar interesin publik, transparencën dhe përdorimin racional të mjeteve buxhetore për këtë projekt me rëndësi publike për zhvillimin e sportit të komunës.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për shqyrtimin e parë të projekt – Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për vitet 2026-2030

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e hapim diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës, fillojmë me Lëvizjen Vetëvendosje.

Kosovar Ademi: E përkrahim.

Laureat Gojnovci: Në parim jemi për ta votuar cdo rregullore por e kam një kërkesë për kryetarin, drejtorët të cilët sjellin propozime në kuvend dhe nuk mund të jenë të pranishëm në seancë, patjetër duhet të jetë dikush të na elaboroj pikën sepse kështu po fillojmë me degradim të Kuvendit, bëj thirrje që nga mbledhja e ardhshme të vijnë drejtorët në mbledhje dhe komitete me na dhënë sqarime shtesë që ne të votojmë.

Migjen Kolshi: Kjo strategji është material voluminoz, shumica e të dhënave janë të marra nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës, pasuritë ujore të Fushë Kosovës nuk janë përfshirë, qëllimet dhe objektivat e zhvillimit ekonomik janë bazuar në pesë shtylla. Nuk është paraparë asnjë investim te kalaja e Harilaçit dhe Bardhit të Madh, disa projekte janë të kopjuara nga komuna e Ferizajit dhe Prishtinës, nuk është strategji e mirëfilltë që e parasheh zhvillimin e komunës tonë, ne si Parti Demokratike nuk e përkrahim.

Ali Ismaili: Po shprehi disa shqetësime, plani i veprimit 2026, në koston totale ka 17,829,000€, dokumenti përmend se burim i buxhetit komunal, grantet qeveritare, donator dhe sektor privat, sa para prej këtyre janë të siguruara sot? Dokumenti tregon se 83% e buxhetit të komunës varet nga grantet qeveritare ndërsa 17% nga të hyrat vetanake, kjo na bën të vetdijshëm sepse nuk e dimë sa do të mund të zbatohet si strategji. Zhvillimi nuk duhet të nënkuptoj vetëm ndërtim, dokumenti parasheh që vetëm 35% e të hyrave vetanake të vijnë nga taksat për lejet e ndërtimit, kjo strategji prodhon shumë paqartësi. Rritja e popullsisë kërkon planifikim serioz e kjo strategji nuk është serioze në raport me rritjen e popullsisë, parashikimet e organizatave ndërkombëtare joqeveritare përkitazi me komunën e Fushë Kosovës, rritja e popullsisë nënkupton rregullimin e rrugëve, shkollave, çerdheve, hapësirave të gjelbërta etj. Objektivat duhet të maten me rezultate, strategjia përmend mbështetjen e biznesve, rritje të vendeve të punës por strategjia duhet të theksoj sa biznese do të mbështesë, sa qytetarë do të përfitojnë e tjera. Transparenca, strategjia parashikon konsultime publike, matjen e kënaqshmërisë së qytetarëve, mekanizmin e raportit, të gjitha këto duhet të parashihen. Faleminderit.

Driton Ademi: Kjo strategji ka shumë lëshime, po i përmendi dy kur flitet të historiku socio-ekonomik dhe demokratik, aty thuhet që kanë lëviz popullata serbe prej qytezës në drejtim të Bresjes deri në Graçanicë, ju po doni me dokumentu që ka pasur përndjekje nga ana jonë, kërkojë

të hiqet kjo pjesë deri në shqyrtimin e dytë. Të thuhet se planifikohet ndërtimi i autostradës Morinë- Merdare, i cili do të ketë ndikim ekonomik, Fatmir Limaj, e ka përfunduar atë autostradë, ju duhet të paraqisni sa ka ndikuar kjo autostradë e jo të thuhet se do të ndërtohet. Këto lëshime nuk guxojnë të ndodhin.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Besoj se gabimet terminologjike do të rregullohen deri në leximin e dytë, nëse ska diskutime tjera po e qesim në votim 'Propozimin për shqyrtimin e parë të Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për vitet 2026-2030'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', pesë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e një pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për shqyrtimin e parë të projekt – Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për vitet 2026-2030' dhe mori:

VENDI

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të 'Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2030'.
2. Projekt-Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2030, e cekur në pikën një të këtij vendimi, cakton objektivat për zhvillim ekonomik për periudhën pesë vjeçare në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2030.

Pika e shtatë (7) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për lëshimin e lejeve për instalimin e paneleve foto-voltaike në territorin e Komunës së Fushë Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim Projekt-Rregulloren për lëshimin e lejeve për instalimin e paneleve foto-voltaike në territorin e Komunës së Fushë Kosovës, shqyrtimi i parë ka përfunduar, dëgjimi publik është mbajtur, nuk ka ndryshime të mëdha. Po e hapi diskutimin, Lëvizja Vetëvendosje qëndrimi juaj?

Kosovar Ademi: E përkrahim.

Laureat Gojnovci: Nuk kemi të shtojmë diçka.

Migjen Kolshi: Nuk kemi të shtojmë diçka.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqenëse nuk ka diskutime po e qesim në votim Shqyrtimin e dytë të Projekt-Rregullores për lëshimin e lejeve për instalimin e paneleve foto-voltaike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota "për", pesë "kundër" dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e një pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votive e aprovoi 'Shqyrtimin e dytë të Projekt-Rregullores për lëshimin e lejeve për instalimin e paneleve foto-voltaike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

VENDIM

1. Për miratimin e Rregullores për lëshimin e lejeve për vendosjen e paneleve foto-voltaikë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

2. Rregullorja për lëshimin e lejeve për vendosjen e paneleve foto-voltaikë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e lëshimit të lejeve për vendosjen e paneleve foto-voltaikë.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për lëshimin e lejeve për vendosjen e paneleve foto-voltaikë.

Pika e tetë (8) - Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në projekte kapitale për vitin 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e hapim diskutimin për pikën Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në projekte kapitale për vitin 2026.

Kosovar Ademi: E mbështesim propozimin.

Laureat Gojnovci: E mbështesim propozimin.

Migjen Kolshi: E mbështesim propozimin.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqenëse nuk ka diskutime po e qesim në votim, Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare në investime kapitale për vitin 2026.

U votua me unanimitet nga anëtarët e kuvendit, të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në projekte kapitale për vitin 2026' dhe mori:

VENDIM

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1544, të datës 02.09.2026, për ridestinimin e mjeteve financiare në shumë prej: 450,000.00€, nga projekti kapital në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, programi Buxhetimi me Nr. 17502, kodi i projektit Nr. 54403 'Bashkëfinancimi i Projekteve' dhe bartjen e tyre për shpenzim në Drejtorinë e Infrastrukturës, programi Infrastruktura Rrugore me Nr. 18002, për realizimin e projektit kapital për 'Asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi' me infrastrukturë përcjellëse në gjatësi prej 1300 metra' - në kodin e projektit Nr. 20945'.
2. Mjetet financiare të ridestinuara në programet buxhetore dhe kodet e projekteve përkatëse, do të shfrytëzohen për realizimin e projektit kapital të evidentuar në paragrafin një (1) të këtij vendimi, me Nr. 20945.

Pika e nëntë (9) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar kolegë a ka dikush diçka te kjo pikë, nëse jo vazhdojmë te pika tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 14:00 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani